3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit
- Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 8: Termat e Referencës
- Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
- Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4.					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit: 2 (dy) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

TERMAT E REFERENCES

Hyrje

Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale, me fondin me vlerë 1,393,534.12 lekë pa TVSH, nga Buxheti i Bashkisë Tiranë, kërkon të realizojë projekt zbatimin për objektin: “Mur mbajtes b/arme në varrezat Tufinë”.

1 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME DHE GJENDJA EKZISTUESE

Vendodhja:

Spektori i varrezave publike Tufinë shtrihet në lindje të qytetit të Tiranës. Ai ndodhet në rruga “Myslym Keta”, Tufinë Njësia Administrative Dajt.

Përshkrim:

- Spektori i varrezave publike Tufinë në të katër anët është i rrethuar nga objekte banimi me tipologji të ndryshme. Terreni është relativisht i thyer me shpate jo të qëndueshëm.

Vlerësimi fizik i objektit:

- Muri mbajtës në spektorin e varrezave publike Tufinë duhet të ndërtohet në jug të territorit të varrezave, parcelës nr.130, nr.131 dhe nr.63/1 Për arsye të terrenit të thyer e të rrëshqitshëm është e domosdoshme ndërtimi i një muri mbajtës për të mbrojtur varret nga një rrëskitje. Ndërhyrja që parashikohet të realizohet në këtë investim është ndërtimi i murit mbajtës b/a i përshtatur sipas terrenit.

Kapaciteti: Nga verifikimet e kryera në terren:

- Muri mbajtës në spektorin e varrezave publike Tufinë (parcelës nr.130, nr.131 dhe nr.63/1) ka një gjatësi afërsisht 113 m me lartësi të sipas terrenit.

Objekti i studim - projektimit do të jetë:

“ Ndërtimi i murit mbajtes betonarme në varrezat Tufinë” propozohet për ndërtim të ri pasi nuk ekziston Ai do të parandaloj rrëshqitjen e dherave dhe për pasojë dhe mirëmbajtjen e varreve me të gjithë parametrat për zhvillimin në kushte normale të punës, duke respektuar kriteret teknike te projektimit dhe standartet në fuqi.

2. OBJEKTIVI, QËLLIMI DHE REZULTATET QË PRITEN

Objektivi

Nëpërmjet këtij projekti synohet ndërtimi i murit mbajtës betonarme me qëllim ruajtjen e territorit.

Për të siguruar cilësinë e ndërhyrjes do të zhvillohet procesi i përzgjedhjes së studios projektuese nëpërmjet një gare kombëtare ku do të vlerësohen propozimet teknike dhe oferta ekonomike.

Qëllimi

- Qëllimi kryesor është mbrojtja nga rrëshkitjet e terrenit të varrezave.
- Mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i territorit të varrezave.
- Rritja e vlerave arkitektonike të zonës

(a) 3. KËRKESAT E PROJEKTIT

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri. Të respektoj eurocodet.

3.1 Infrastruktura e murit mbajtës

Për trajtimin e murit mbajtës duhet të mbahen parasysh standartet në fuqi (Rregullorja e urbanistikës, KTP , eurokodet).

Në variantet që do të propozohet duhet që:

- 1). Muret mbajtës të trajtohen sipas standarteve në fuqi.
- 2). Të shikohet mundësia e sistemimit të ujrave të bardhë.

Muri mbajtës të trajtohet i tillë, që të sigurojë garanci e qëndrueshmëri.

Materialet, që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit për muret mbajtës.

Projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Agjencinë e Shërbimeve Funerale, Tiranë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

1. Të bëjë relievin (azhornimin) e terrenit që do të ndërtohet, të jepet plani i piketimit
2. Projektuesi duhet të bëjë verifikim paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës përpara fillimit të projektimit. Kjo

duhet në mënyrë që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra, që nuk përputhen me gjendjen në terren;

3. Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, etj. (sipas kërkesave të projektimit)

3.2 Gjendja aktuale e terrenit

Projektuesi harton paraprakisht:

1. Relacion teknik;
2. Një analizë të situatës ekzistuese, në raport me efektet sociale, që mund të sjellë projekti dhe të elementeve të kosto-efektivitetit dhe të ndikimit ekonomik, funksional dhe mjedisor të ndërhyrjes.

Qëllimi i kësaj faze është, që projekti të ketë analizë të përputhshmërisë me planet, eficientë ekonomike të ndërhyrjes, pra efektivitet të koston, minimizim të impakteve negative sociale.

4. KËRKESA MBI KONDICIONET KONSTRUKTIVE DHE FUNKSIONALE

Themelet

Për ndërtimin e një objekti të ri është e domosdoshme përcaktimi i vetive fizike dhe mekanike të dherave dhe masave gjeologjike që përcaktojnë terrenin ku parashikohet të ngrihen muret mbajtës në fjalë.

Konstruksioni

Ndërtimi i mureve do të jetë prej betoni të armuar. Është detyrë e konsulentit të zbatojë Kushtet Teknike të Projektimit shqiptar, specifike për objektin në fjalë, si dhe standartet e miratuara, lidhur me materialet që do të përdoren.

5. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të eficientë së ndërhyrjes, projektuesi duhet t'i rekomandojë investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të projektit.

Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit, që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, vendosje).

Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozojë fazat e realizimit të projektit, ku të dhënat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit (buxhetim, prokurim, kontraktim për zbatim) të projektit me faza.

5.1 Standartet

5.1.1 Standarte në projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

5.1.2 Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, ligji nr.8402, datë 10.9.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", I ndryshuar, VKM nr.408, date 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar, VKM Nr. 9, datë 11.1.2024, "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste" dhe Legjislacioni në fuqi.

5.2 Realizimi i projektit

Realizimi i projektit do të mbështetet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Neni 36, 37 dhe Neni 38.

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/termave te referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit: Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit.

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (dwg, excel, word etj.)

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohen:

1. Vizatimet teknike (planimetri e përgjithshme, prerje të murit mbajtës për secilin variant);
2. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara);
3. Preventiv paraprak.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Drejtoria e Shërbimeve Operacionale e Agjencisë së Shërbimeve Funerale, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specififikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (dwg, excel, word etj.)

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas pwrzgjedhjes nga Drejtoria e Shërbimeve Operacionale të Agjencisë së Shërbimeve Funerale të variantit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë-paraprake, procedohet me projekt-idenë përfundimtare, e cila duhet të përmbajë:

- a) Raport teknik;
- b) Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.
- c) Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.
- d) Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse;
- e) Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
- f) Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- g) Rilevimi;
- h) Studimi gjeologjik.

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (dwg, excel, word etj.)

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, I ndryshuar, VKM nr.408, date 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, VKM Nr. 9, datë 11.1.2024, “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste” dhe Legjislacioni në fuqi, për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit për miratim në Këshillin Teknik të Bashkisë Tiranë dhe për aplikim për oponencën teknike pranë Institutit të Ndërtimit, të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

FAZA V: Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin: “ **Mur mbajtes b/arme në varrezat Tufinë**”, duhet të përmbajë:

- Raporti teknik;
- Hartimi i relievit topografik të murit në çdo sektor (koordinata lokale, kuota absolute);
- Raport gjeologjik;
- Profilin gjatësor të murit;
- Prerje tërthore të mureve;
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
- Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;
- Grafikon e punimeve të ndërtimit;
- Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që o të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbësht etur dhe në grafikun e punimeve;
- Raportin e vlerësimit të dikimit në mjedis (VNM);
- Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor ekstrkt i regjistrit tregtar.

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dwg, word, excel.

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, llogaritjes së volumeve metrike duke pasur parasysh VKM Nr. 9, datë 11.1.2024, “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

- **Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe sipas Ligjit Nr.120/2020, datë 7.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 6 Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:**

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë)lekë;

c) objektet me akses publik.

2. Për çdo rast, institutet shtetërore ose entet e tjera, që kryejnë oponencën teknike, janë solidarisht përgjegjëse me projektuesin për çdo dëm që rrjedh si pasojë e gabimeve ose të metave të oponencës teknike, si dhe mbajnë përgjegjësi administrative ose penale, sipas rastit, për shkeljen e legjislacionit në fuqi.

Rregullat për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

- Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe sipas VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Reupublikës së Shqipërisë nga subjektet fizike dhe juridike, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponencë teknike”, në Institutin e Ndërtimit, sipas afateve përkatëse. (të miratuara përkatësisht nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike).

6. Rekomandime për projektuesin

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me rrugët. Projektuesi duhet të hartojë, përveç projektit përfundimtar dhe një projekt teknik, i cili duhet të analizojë rast pas rasti të gjitha prishjet e mundshme për të realizuar me faza këte investim.

Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake, që disponohen nga Agjencia e Shërbimeve Funerale Tiranës. Në hartimin e projektit duhet të merren në konsideratë edhe VKM Nr.712, datë 29.10.2014, “Për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

6.1 Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë:

Gjelbërimin dhe mobilimin urban;

Punimet provizore.

Projektuesi duhet të bëjë verifikimet paraprake në terren dhe studime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës, përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit.

Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të Projektimit të Ndërtimit. Në përfundim mund të thuhet se projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Agjencinë e Shërbimeve Funerale përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si dhe gjatë gjithë fazave të projektimit dhe zbatimit të tij, dhe kjo si për garantimin e saktësië së bazës së të dhënave

ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura si më sipër.

6.2 Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar:

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Shërbimeve Funerale. Stafi, që kërkohet duhet të përfshijë:

1. Inxhinier ndërtimi KONSTRUKTOR (STRUKTURIST)
2. Inxhinier topograf;
3. Inxhinier mjedisi;
4. Inxhinier gjeolog
5. Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

7. Raportimi

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 5 (pesë) kopje , në format soft copy dhe hard copy dhe 5 (pesë) kopje në CD. Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar, i cili transferohet në GIS.

Një nga këto kopje do të nevojitet për aplikim në Këshillin Teknik të Bashkisë Tiranë.

Në rast se projektit do t'i duhet t'i nënshtrohet oponentës teknike, e cila zhvillohet nga Instituti i Ndërtimit, do të nevojitet një kopje e plotë e gjashtë fizike dhe elektronike (soft copy dhe hard copy) e projektit të zbatimit.

Projekti do t'i nënshtrohet Oponentës Teknike duhet te shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Dokumentacioni ligjor përfshin:

- a) licencat përkatëse të personit juridik apo fizik projektues/projektuesit;
- b) dëshmitë e kualifikimet përkatëse;
- c) policën e sigurimit;
- ç) deklaratën e përgjegjësisë profesionale të projektuesit;
- d) kontratën e shërbimit midis zhvilluesit dhe investitorit.

2. Dokumentacioni teknik përfshin:

- a) përshkrimin teknik të punimeve të ndërtimit;
- b) përmasimin dhe preventivin e plotë të projektit dhe volumeve;
- c) detajet e nevojshme, në shkallën 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e elementeve me përshkrimin e materialit, në shkallën 1:50;
- ç) projektin konstruktiv;
- d) relacionin gjeomekanik të truallit;
- dh) projektin e punimeve përgatitore/paraprake, si gërmimi, punimet për përforcimin e tokës, sigurimi i gropës nën kuotën e sistemuar;
- e) planin e organizimit të kantierit;
- ë) planin e sigurisë në kantier;

f) planin e masave në rastet e prishjeve të mundshme.

3. Projekti strukturor duhet të përfshijë:

a) specifikimet teknike, udhëzimet teknike dhe vizatimet në përputhshmëri me normat dhe rregullat e projektimit në fuqi;

b) rrethanat projektuese për sigurinë strukturore, konceptin dhe veçantitë e skemës strukturore, përfshirë rregullsinë e saj;

c) vizatimet e përgjithshme dhe hollësitë inxhinierike; Për secilën të ketë të paraqitur së paku dy prerje karakteristike në lartësi me pozicionim të elementeve në shkallë 1:100 ose 1:50, si dhe pjesë të veçanta (detaje) në shkallë 1:25. Në rastet e ndërtimeve, të cilat zhvillohen pjesërisht ose plotësisht nën tokë, në vizatimet e projektit duhet të jepen edhe vizatimet dhe hollësitë përkatëse inxhinierike si për veprat apo masat mbrojtëse të veprës që ndërtohet ashtu edhe për veprat fqinje të cilat ndikohen nga ndërhyrja e parashikuar;

ç) analizat strukturore statike dhe dinamike (në veçanti veprimi sizmik dhe i erës dhe çfarëdo veprimi tjetër që nevojitet në vendin ku ndërtohet vepra) pavarësisht material-it/eve parësor/e strukturor/e me të cilin/cilat është konceptuar struktura dhe mënyra e ndërtimit (e derdhur në vend apo parafabrikuar). Këto analiza kryhen si për gjendjet e fundit kufitare ashtu edhe për gjendjet kufitare të shërbyeshmërisë (përdorimit). Në rastet kur vepra zhvillohet pjesërisht apo tërësisht nën tokë apo kur janë të nevojshme gjurmime për vendosjen e saj, analiza gjeoteknike dhe strukturore është e domosdoshme si për veprat mbrojtëse të shpateve ashtu edhe për ndërveprimin e strukturës me mjedisin ndërveprues;

d) vendndodhjen, natyrën dhe intensitetin e ngarkesave dhe veprimeve, përshkrimet dhe kombinimet tyre në harmoni me kushtet teknike të projektimit në fuqi, faktorët pjesorë të sigurisë e të kombinimit në përputhje me rrethanat projektuese, gjendjet kufitare të projektimit dhe llojin e veprës;

dh) llogaritjet e ekuilibrit të përgjithshëm, kontrollet në përmbysje, rrëshqitje, mosshembje, duke përfshirë llogaritjet në qëndrueshmëri, zhvendosjet tërësore dhe relative, dukurinë P- Δ përfshirë epjen e pjesshme apo verifikime të tjera me natyrë jolineare që mund të çojnë strukturën e veprës në gjendje plastike në marrëdhëniet sforcim-deformim;

e) përmasat e fugave sizmike apo fugave termike (bymim-tkurtje) si dhe tolerancave të nevojshme për rastet kur vepra mbështetet në mjedise që shkaktohen çedime të ndryshme etj.;

ë) kërkesat për duktilitet tërësor, duktilitet të pjesshëm dhe për duktilitet të elementeve parësore sizmike rezistuese;

f) të gjitha elementet parësore strukturore, pavarësisht materialit të tyre përbërës, si dhe ndikimi në sjelljen e sigurinë tërësore strukturore në rastet kur me norma teknike kërkohet marrja e masave për sigurinë ndaj zjarrit;

g) hollësitë inxhinierike (prerjet, nyjat, bashkimet, fugat, bashkimet me bulona apo saldim etj.) - të punuara dhe të paraqitura në atë mënyrë që të plotësojnë kriteret e rregullave teknike për projektim, të lexueshme dhe të kuptueshme për zbatim në shkallën 1:5; 1:10; 1:20; 1:25; 1:50, në varësi të shkallës së vështirësisë dhe shkallës së ngatërimit së strukturës, që duhet të jepen në mënyrë numerike, në përputhje me normat në fuqi;

h) të gjitha llogaritjet e kryera dhe dokumentet e hartuara për qëllimin e projektimit të veprës që duhet të jenë në përputhje me kushtet teknike të projektimit në fuqi, kushtet teknike të ndërtimit si dhe standardet SSHEN.

8. Relacioni teknik, i cili shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik duhet të përmbajë dhe llogaritjet statike të strukturave, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, raporti gjeologjik, Preventivi i plotë i kushtimit të veprës.
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

9. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimalisht fletët si mëposhtë:

1. Topografinë e gjëndjes egzistuese në Shk. 1:500 ose 1:1000
2. Planimetria e sistemit të terrenit në Shk. 1:500 ose 1:1000
3. Profilet gjatesorë të mureve Shk. 1:1000, 1:100.
4. Prerje tërthorë të mureve.
5. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
6. Plan organizimim e punimeve.
7. Preventivin e plote të punimeve që parashikohen të kryen

Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

10. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

11. Sqarime të fundit



Gjurma e murit mbajtës të territorit të varrëzave “Tufinë”

12 Foto nga terreni



Foto nga parcela 130





Foto nga parcela 131-63/1



Foto nga parcela 63/1

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlogaritur**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për kështet e maturuara për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas

përcaktimeve të Ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, për të gjitha vëndet ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë, vërtetim të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen

2. Operatorit ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale (e vlefshme) për projektim, sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e projektimit në ndërtim, ku të përfshihen kategorite:

KAT 3 PROJEKTUES KONSTRUKTOR:

3/c/2. Troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët;

KAT 8 PROJEKTUES GJEODET:

8/a Rilevime inxhinjerike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim, lëshuar nga institucione të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e projektimit në ndërtim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik, të përfshirë si drejtues teknik në Liçencën e shoqërisë dhe në listëpagesat e muajve Mars - Maj 2026 sa më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi/ Strukturist/Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf/Gjematik

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhën Mars-Maj 2026 te deklaruar si dhe listëpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Per stafin e mesiper Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë, CV .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

